



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:096393
Datë: 12.02.2024
Numri i dokumentit: 05314884

C.nr.2111/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësve S. H.-H., F. A., T. D., Q. K.-S., dhe N. K., të cilat sipas autorizimit i përfaqëson avokat A. H. nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i pagës mbi bazën e inflacionit, jashtë seancës, me datë 08.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve S. H.-H., F. A., T. D., Q. K.-S., dhe N. K. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditësve t’i paguaj shumat si në vijim :

Paditëses së parë: S. H.-H., në emër të kompensimit për inflacion për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 997.52 €.

Paditëses së dytë: F. A., në emër të kompensimit për inflacion për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 1,015.27 €.

Paditëses së tretë: T. D., në emër të kompensimit për inflacion për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 981.55 €.

Paditëses së katërt: Q. K.-S., në emër të kompensimit për inflacion për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 965.56 €.

Paditëses së pestë: N. K., në emër të kompensimit për inflacion për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 933.53 €.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëseve t’ia paguaj kamatën në lartësi prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë datë 16.05.2022 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 332.00€, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditëset përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate, me datë 16.05.2022, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim e pagave mbi bazën e inflacionit. Në padi dhe në precizimin e datës 05.02.2024 ka theksuar se paditëset janë të punësuar tek e paditura në SHFMU “Shkëndija” në Prishtinë. Tutje ka shtuar se paditëset i plotësoj kushtet për përfitimin e kompensimit në pagë mbi bazën e inflacionit vjetor, e drejt kjo e garantuar sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës neni 35 par.10. I njëjti ka shtuar se paditësve nuk i ‘u është bërë kompensimi në pagë mbi bazën e inflacionit vjetor dhe atë: për paditësen e parë S. H.-H., për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 997.52 €, për paditësen e dytë F. A., për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 1,015.27€, për paditësen e tretë T. D., për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 981.55€, për paditësen e katërt Q. K.-S., për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 965.56€, dhe për paditësen e pestë N. K., për periudhën kohore prej 01.06.2019 deri në 21.11.2022, gjithsej për 42 muaj, t’ia paguaj shumën prej 933.53€, me kamatë ligjore 8% nga data e arritjes për pagesë e deri në pagesën definitive, duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, për arsye se një kompensim i tillë nuk është paraparë as me Ligjin e Punës nr.03/L-212. Po ashtu ka shtuar se, në rastin konkret ekziston parashkrimi i kërkesës pasi që konform dispozitave të LMD-së, pagesat mujore qoftë nga marrëdhënia e punës apo kompensime tjera mujore parashkruhen brenda afatit 3 vjeçar. Tutje ka theksuar se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore, linje të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimeve. Prandaj, ka kërkuar nga gjykata pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, por se e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratave të lëshuara nga e paditura dhe atë: paditësen S. H.-H. sipas kontratës nr. prot.248/I të datës 01.09.2021, paditësen F. A. sipas kontratës me nr. prot. 288/2

të datës 16.03.2016, paditësen T. D. sipas kontratës nr. prot. 286/1 të datës 16.03.2016, paditësen Q. K.-S. sipas kontratës me nr. prot. 67/2 të datës 05.03.2018, dhe paditësen N. K. sipas kontratës me nr. prot. 59/2 të datës 15.01.2016.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditëset nuk kane pranuar kompensimin në pagë në emër të inflacionit vjetor, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i gjendjes faktike, vërehet se paditësja S. H.-H. në emër të kompensimit për inflacion i takon shuma e përgjithshme prej 997.52€, pasi që shkalla e inflacionit për periudhën 01.06.2019 deri 31.12.2019 ka qenë 2.7%, andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 525.85 x 2.7%=14.19€) shumëzuar për 7 muaj përfitohet shuma 99.38€, për periudhën kohore 01.01.2020 deri 31.12.2020 ka qenë 0.2% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 525.85€ x 0.2%=1.05€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 12.62€, për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021 ka qenë 3.4% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 525.85€ x 3.4%=17.87€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 214.54€, për periudhën kohore 01.01.2022 deri 21.11.2021 ka qenë 11.6% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 525.85€ x 11.6%=60.99€) shumëzuar për 11 muaj përfitohet shuma 670.98€, për paditësen F. A. në emër të kompensimit për inflacion i takon shuma e përgjithshme prej 1,015.27€, pasi që shkalla e inflacionit për periudhën 01.06.2019 deri 31.12.2019 ka qenë 2.7%, andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 536.38 x 2.7%=14.48€) shumëzuar për 7 muaj përfitohet shuma 101.73€, për periudhën kohore 01.01.2020 deri 31.12.2020 ka qenë 0.2% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 536.38€ x 0.2%=1.07€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 12.87€, për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021 ka qenë 3.4% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 536.38€ x 3.4%=18.23€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 218.84€, për periudhën kohore 01.01.2022 deri 21.11.2021 ka qenë 11.6% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 536.38€ x 11.6%=62.22€) shumëzuar për 11 muaj përfitohet shuma 684.42€, për paditësen T. D. në emër të kompensimit për inflacion i takon shuma e përgjithshme prej 981.55€, pasi që shkalla e inflacionit për periudhën 01.06.2019 deri 31.12.2019 ka qenë 2.7%, andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 517.43 x 2.7%=13.97€) shumëzuar për 7 muaj përfitohet shuma 97.79€, për periudhën kohore 01.01.2020 deri 31.12.2020 ka qenë 0.2% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 517.43€ x 0.2%=1.03€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 12.41€, për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021 ka qenë 3.4% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 517.43€ x 3.4%=17.59€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 211.11€, për periudhën kohore 01.01.2022 deri 21.11.2021 ka qenë 11.6% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 517.43€ x 11.6%=60.02€) shumëzuar për 11 muaj përfitohet shuma 660.24€, për paditësen Q. K.-S. në emër të kompensimit për inflacion i takon shuma e përgjithshme prej 965.56, pasi që shkalla e inflacionit për periudhën 01.06.2019 deri 31.12.2019 ka qenë 2.7%, andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 490.05€ x 2.7%=13.23€) shumëzuar për 7 muaj përfitohet shuma 92.61€, për periudhën kohore 01.01.2020 deri 31.12.2020 ka qenë 0.2% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 490.05€ x 0.2%=0.98€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 11.76€, për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021 ka qenë 3.4% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 490.05€ x 3.4%=16.66€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 199.94€, për periudhën kohore 01.01.2022 deri 21.11.2021 ka qenë 11.6% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 490.05€ x 11.6%=56.84€) shumëzuar për 11 muaj përfitohet shuma 625.30€, dhe për paditësen N. K. në emër të kompensimit për inflacion i takon shuma e

përgjithshme prej 933.53€, pasi që shkalla e inflacionit për periudhën 01.06.2019 deri 31.12.2019 ka qenë 2.7%, andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 492.16€ x 2.7%=13.28€) shumëzuar për 7 muaj përfitohet shuma 93.01€, për periudhën kohore 01.01.2020 deri 31.12.2020 ka qenë 0.2% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 492.16€ x 0.2%=0.98€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 11.81€, për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021 ka qenë 3.4% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 492.16€ x 3.4%=16.73€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 200.80€, për periudhën kohore 01.01.2022 deri 21.11.2021 ka qenë 11.6% andaj ka llogaritur pagën e paditëses (paga 492.16€ x 11.6%=57.09€) shumëzuar për 11 muaj përfitohet shuma 627.99€, rrjedhimisht duke u 'a njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Këtë lloj kompensimi gjykata i'a njohu paditësve në harmoni me nenin 35 par.10, të KKAK-së, ku është paraparë se: "Për çdo vite të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë".

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 35 par.10 është paraparë e drejta punëtoreve të arsimit në kompensimin e inflacionit në pagë, gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, e cila i 'u garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit "Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë". Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësve për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në pagë mbi bazën e inflacionit, të njëjtat janë legjitimuar që të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditëset e ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij". Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësve, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t'ia kompensoj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, sepse e paditura nuk e konteston bazën e kërkesës, e as lartësinë e kërkesës së paditësës, me anë të përgjigjes në padi. Ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës, se për këtë objekt të kërkesë e paditura nuk ka planifikuar buxhet dhe nuk kanë vijë buxhetore për ta realizuar këtë kompensim, nuk është rrethanë e natyrës juridike që ndikon për te marr vendim ndryshe në këtë rast. Prandaj gjykata erdhi në përfundim

se faktet në këtë rast, nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor dhe se pala e paditur është obliguar ta përmbush obligimin ndaj paditësve. Ndërsa lidhur me pretendimet se kemi kërkesë të parashkruar të paditësve gjykata këtë pretendim e ka gjetur si të pa bazuar për faktin se në rastin konkret paditësit kanë kërkuar realizimin e kësaj të drejte për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, ndërsa padinë e ka ushtruar në gjykatë në vitin 2022, rrjedhimisht nuk kemi të bëjë me parashkrim pasi që nuk ka kaluar afatit 3 vjeçar.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 16.05.2022.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 332.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 312.00€ - sipas tarifës së OAK dhe taksa gjyqësore në shumë prej 20.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2111/22, datë 08.02.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.